



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
Përmbarues Gjyqësor ILIA ELEZI

Adresa: "Rruga e Kavajës", Condor Center, Kati 2, Tiranë, Tel. 068 40 26 666 / 069 32 62 866, E-mail: ilia.elezi@nchb.al  
Nr. 494 Regj. Tiranë, më 03.08.2022

Nr. 410 Prot.

**URDHËR PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE**

**Drejtuar:** Qendrës Kombëtare të Biznesit  
**Për dijani kreditorit:** Dega e Doganës Tiranë  
**Për dijani debitorit:** Shoqëria "V-Morina" Sh.P.K., NUIS L813160600  
**Baza ligjore:** Neni 527 i Kodit të Procedurës Civile.

Unë, Ilia Elezi, përmbarues gjyqësor privat, me NUIS: L22410011C, i pajisur me certifikatë Nr. 125 Nëntor 2012, lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, në lidhje me dosjen përmbarimore **Nr. 494 Regjistri**, me palë dhe objekt:

- **Kreditor:** Dega e Doganës Tiranë
- **Debitor:** Shoqëria "V-Morina" Sh.P.K., NUIS L813160600
- **Objekt:** Rikuperim i borxhit doganor

në zbatim të titullit ekzekutiv "Vendim Nr. 09, datë 24.02.2021 "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës", i Degës së Doganës Tiranë", për të cilin është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit "Vendimi Nr. 508 Regjistri, datë 05.04.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë", **në kushtet kur nga ana e debitorit nuk janë shlyer detyrimet vullnetarisht**, bazuar në nenin 527 të Kodit të Procedurës Civile,

**URDHËROJ:**

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative ndaj kuotave apo aksioneve në pronësi/bashkëpronësi të palës debitore, **shoqërisë "V-Morina" Sh.P.K., me NUIS L813160600.**
2. Për veprimet ose mosveprimet tuaja duhet të vihem në dijani shkresërisht, brenda afatit të parashikuar ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë do të ndërmarr sanksione ligjore, bazuar në nenin 53 të Ligjit Nr. 26/2019 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", si dhe në nenin 606 të Kodit të Procedurës Civile, duke filluar nga gjobë 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë e deri në kallëzim penal.
4. Kundër këtij urdhri lejohet ankim në Gjykatë brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes dijani.

PËRMBARUESI GJYQËSOR  
ILIA ELEZI

